



ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi i Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 20.01.2021, mori në shqyrtim praktikat e përgatitura nga drejtoritë teknike e ERE-s, dhe u shpreh si më poshtë:

1. Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës Nr. 443, Seria P19, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike dhënë Shoqërisë “SANG 1” sh.p.k., me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 83, datë 31.05.2019, i ndryshuar, si dhe licencës nr. 447, Seria T19, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “SANG 1” sh.p.k., me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 106, datë 26.06.2019.
2. Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “GERTI” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Vardari” me kapacitet të instaluar 1972 kW.
3. Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “GERTI” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
4. Mbi zgjatjen e afatit të vendimmarrjes së Bordit të ERE-s në lidhje me kërkesën e shoqërisë “SEMAN SUNPOWER” sh.p.k., për transferim të aseteve (vendosje hipoteke) në favor të “Intesa Sanpaolo Bank” sh.a..
5. Për rinovimin e licencës së shoqërisë “ENERGY SUPPLY - AL” sh.p.k., Nr 115/309, Seria T11/T15, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 6, datë 02.02.2011 dhe rinovuar me Vendimin Nr. 122, datë 14.10.2015.
6. Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë “ENERGY SUPPLY - AL” sh.p.k., Nr 115/310, Seria F11/FK15, në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 5, datë 02.02.2011 dhe rinovuar me vendimin Nr. 123, datë 14.10.2015.
7. Mbi disa ndryshime në Vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 140, datë 24.09.2019, “Mbi licencimin e shoqërisë “IRARBA ENERGJI” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga hec “SHËNGJUN” me kapacitet të instaluar 2040 kW”.
8. Mbi çmimin vjetor të blerjes së energjisë elektrike që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi për vitin 2021.

9. Mbi përfundimin e procedurës administrative të filluar me Vendimin e Bordit të ERE Nr. 230, datë 15.12.2020 “Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës Nr. 415, Seria P18K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “BLAC ENERGY” sh.p.k., me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 157, datë 09.07.2018.
10. Mbi përfundimin e procedurës administrative të filluar me Vendimin e Bordit të ERE Nr. 235, datë 15.12.2020 “Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës Nr. 369, Seria TGN17, për veprimtarinë e tregtimit të gazit natyror, dhënë Shoqërisë “C.G.C” sh.p.k., me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 73, datë 16.05.2017.
11. Mbi përfundimin e procedurës administrative të filluar me Vendimin e Bordit të ERE Nr. 225, datë 15.12.2020 “Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës Nr. 202, Seria PV13K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë Shoqërisë “HEC TRESKA” sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 80, datë 27.04.2013.
12. Mbi lënien në Fuqi të Vendimit të Bordit Nr. 122, datë 29.07.2019 “Mbi miratimin e Draft Kontratës ndërmjet KESH sh.a. dhe OSSH sh.a, për shitblerjen e sasisë së tepërt të energjisë elektrike, që rezulton pas përmbushjes së kërkesës së klientëve që përfitojnë nga shërbimi universal me qëllim mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për periudhën kohore 01.01.2019-31.12.2019.